

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.04.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 04.04.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 423, të datës 25.03.2024, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 27, të datës 04.03.2024, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 50, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare Nr. 20/2016), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç), nenin 54 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 27, të datës 04.03.2024 për rritjen e të hyrave vetanake në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023

1. Për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 27, të datës 04.03.2024 për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2023 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 389,203.44€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore: paga e shtesa, subvencione e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet buxhetore të programeve, nënprogrameve dhe projekteve si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare në shumë prej: 15,176.72€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa - 11, në kodin e programit Administratën e Arsimit me numër 92010;
 - 1.2 Mjetet financiare në shumë prej: 164,366.74€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, në kode të programeve dhe nënprogrameve me korrigjimin e tyre:
 - 1.2.1 Në Infrastrukturë Publike - Fushë-Kosovë 18162, shuma e mjeteve financiare prej: 10,000.00€;
 - 1.2.2 Në Shërbimet Sociale - Fushë-Kosovë 75506, shuma e mjeteve financiare prej: 45,000.00€.
 - 1.2.3 Në Shërbime Kulturore - Fushë-Kosovë 85002, shuma e mjeteve financiare prej: 74,823.28€
 - 1.2.4 Në Administratën e Arsimit – Fushë-Kosovë 92010, shuma e mjeteve financiare prej: 34,543.46€ dhe
 - 1.3 Mjetet financiare në shumë prej: 209,659.98€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike investime kapitale - 30, në kodin e programit dhe kodin e projektit:
 - 1.3.1 Në Shërbime Kulturore - Fushë-Kosovë 85002, për projektin 'Palestra Sportive në Fshatin Sllatinë e Vogël', kodi i projektit me numër 51386, shuma e mjeteve

financiare prej: 189,659.98€;

1.3.2 Në Administratë - Fushë-Kosovë 16302 'Dixhitalizimi i Sallës së Kuvendit Komunal në Fushë-Kosovë', kodi i projektit 49315, shuma e mjeteve financiare prej: 20,000.00€.


2. Mjetet financiare në shumë të përgjithshme prej: 389,203.44€ nga paragrafi 1, të zërthyer në nën paragrafin 1.1 - në kategorinë paga dhe shtesa në Administratën e Arsimit shpenzohen për mbarëvajtje të procesit mësimorë për mësimin joformal, nënparagrafi 1.2 - në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere, nënparagrafi 1.2.1 në Infrastruktura Publike shpenzohen për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, nënparagrafi 1.2.2 në Shërbimet Sociale shpenzohen për qiratë e rasteve sociale, nënparagrafi 1.2.3 në Shërbime Kulturore shpenzohen për përkrahje financiare të Organizatave Jo Qeveritare në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, nënparagrafi 1.2.4 në Administrata e Arsimit - Fushë-Kosovë, shpenzohen për ndihma për studentë, paragrafi 1.3 - nënparagrafi 1.3.1 në kategorinë ekonomike të Investimeve Kapitale, në programin Shërbimet Kulturore, shpenzohen në kodin e projektit për 'Palestrën Sportive në fshatin Sllatinë e Vogël' dhe nënparagrafi 1.3.2 shpenzohen Administratë - Fushë-Kosovë për kodin e projektit për 'Dixhitalizimin e Sallës së Kuvendit Komunal në Fushë-Kosovë'.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 11.04.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 04.04.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 424, të datës 25.03.2024, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, për shfuqizimin e vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023, lidhur me aprovimin në parim të vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023 të 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e aprovimit në parim të vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023 të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës


1. Për shfuqizimin e aprovimit në parim të vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023 të 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë Kosovës'.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 11.04.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 04.04.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 424, të datës 25.03.2024, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

**Për aprovimin në parim të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave
në Komunën e Fushë-Kosovës**


1. Për aprovimin në parim të 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe procedimin e saj për diskutim publik.
2. Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e menaxhimit, ndarjen e mbeturinave në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publik është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 11.04.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 04.04.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 500, të datës 12.03.2024, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, (Gazeta Zyrtare Nr.30/2008), nenin 20, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2011), nenin 6 paragrafi 1, 2, 3 dhe nënparagrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 48, paragrafi 8, të Rregullores për Organizimin Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale nr. 125, të datës 25.09.2014 mori:

V E N D I M

Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza', në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Për konkursin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza', në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 2.1 Elmije Grajçevci Zymberi - Kryetare e Komisionit Shefe e Drejtorisë së Arsimit;
 - 2.2 Esad Simnica - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza', në Komunën e Fushë-Kosovës;
 - 2.3 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit.
 - 2.4 Gazmend Bekolli - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 2.5 Indire Sahiti - në cilësinë e vëzhguesit.


3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 11.04.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 04.04.2024, pas shqyrtimit të Propozimit 541, të datës 19.03.2024, të paraqitur nga Kryetari i Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 11, të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr. 83, të dates 14.06.2013, mori:

V E N D I M

Për lejimin e shpenzimeve të mjeteve financiare nga subvencionet në bujqësi për vitin 2024


1. Për lejimin e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve për bujqësi në shumë prej: 120,000.00€, nga të hyrat vetanake për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2024 si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Serrave';
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Motokultivatorëve';
 - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 50,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Miksera' dhe
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 30,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Mekanizmit bujqësor'.
2. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë prej subvencioneve, nga paragrafi 1, nën - paragrafët prej 1.1 e deri tek nën - paragrafi 1.4, të paragrafit një të këtij vendimit, bëhet pa participim nga fermerët e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.
3. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës sipas pikës një (1) të vendimit dhe kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është kompetencë e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe Zyrës së Prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Ueb-faqen e Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 394, të datës 13.02.2024, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 27 të Ligjit 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2023 në vitin fiskal 2024

1. Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2023, në vitin fiskal 2024 transfer dhe rialokime në shumë të përgjithshme prej 6,318,133.88€, sipas propozimit dhe përshkrimit në dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 394, të datës 13.02.2024, me ndryshimet e propozuara në Kuvendin e Komunës për 'Dixhitalizimin e Sallës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës', të prezantuara në formën tabelare prej dy faqeve - pjesë e këtij vendimi.
2. Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 2.1 Për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 15,176.72€
 - 2.2 Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 220,944.60€;
 - 2.3 Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 232,520.95€;
 - 2.4 Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 5,849,491.61€.
3. Shpërndarja e mjeteve financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në pikën një dhe dy të vendimit dhe shpenzimet janë të detajizuara dhe të përshkruara, për secilin shpenzim në dokumentin financiar që është pjesë e këtij vendimi.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.


5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.hh

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 11.04.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 04.04.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 423, të datës 25.03.2024, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 27 të Ligjit 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022 dhe 2023, për shpenzim në vitin fiskal 2024

1. Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022 dhe 2023, për shpenzim në vitin fiskal 2024 transfer dhe rialokime në shumë të përgjithshme prej 5,928,930.44€, sipas propozimit dhe përshkrimit të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 423, të datës 25.03.2024 me ndryshime, për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 1.1 Në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime: Infrastruktura Publike Fushë-Kosovë 18162, shuma prej: 73,774.77€;
 - 1.2 Shërbimet e Shëndetësisë primare Fushë-Kosovë 73150, shuma prej: 87,169.83€ dhe
 - 1.3 Planifikimi hapësinor dhe rregullativ Fushë-Kosovë 66015, shuma prej: 60,000.00€.
 - 1.4 Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe transfere: Zyra e Kryetarit Fushë-Kosovë 16002, shuma prej: 23,996.94€;
 - 1.5 Infrastruktura Publike Fushë-Kosovë 18162, shuma prej: 632.08€;
 - 1.6 Administrata Fushë-Kosovë Shëndetësi 73011, shuma prej: 38,280.53€ dhe
 - 1.7 Administrata Fushë-Kosovë Arsim 92010, shuma prej: 5,244.66€.
 - 1.8 Në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në nën - programet si vijon për projektet publike kapitale në Administrata Fushë-Kosovë 16302, në projektet: Blerja e veturave, kodi 49169, shuma prej: 73,020.00€ dhe
 - 1.9 Dixhitalizimi i sallës së Kuvendit Komunal në Fushë-Kosovë, kodi 49315, shuma prej: 10,000.00€.
 - 1.10 Buxheti Fushë-Kosovë 17502, në projektet: Bashkëfinancimi. Projekte të ndryshme sipas prioritetit të Komunës, kodi 44684, shuma prej 64,878.60€.
 - 1.11 Infrastrukture Publike Fushë-Kosovë 18162, në projektet: Vendosja e Ndriçimit Publik

- dhe mirëmbajtja e tyre, kodi 44697, shuma prej 91,385.78€;
- 1.12 Vendosja e kamerave nëpër pikat kryesore të qytetit, kodi 44715, shuma prej: 35,257.94€;
- 1.13 Rregullimi i parkut në pisha të Sllatinës së Vogël, kodi 44699, shuma prej: 152,688.75€;
- 1.14 Shënjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, kodi 52490, shuma prej: 126,545.00€;
- 1.15 Rregullimi i sheshit në lagjen Dardania, kodi 49363, shuma prej: 735,746.47€;
- 1.16 Ndërtimi i urave, shtratit të lumenjëve, liqeneve, përroskave etj, kodi 49420, shuma prej: 100,793.40€;
- 1.17 Ndërtimi i parqeve, trotuareve, këndi i lojërave dhe mbjellja e pemëve dekorative, kodi 52489, shuma prej: 54,197.80€ dhe
- 1.18 Ndërtimi i katit shtesë - Kati II të objektit të Komunës, kodi 51330, shuma prej: 104,776.50€.
- 1.19 Zhvillimi dhe inspektimi bujqësor Fushë-Kosovë 47042, në projektet: Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura në fshatin Harilaç, kodi 53994, shuma prej: 14,800.00€.
- 1.20 Planifikimi hapësinor dhe rregullativ Fushë-Kosovë 66015, në projektet: Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit - fshatra, qytet, kodi 49732, shuma prej: 1,551,675.66€;
- 1.21 Asfaltimi në Fushë-Kosovë, kodi 44776, shuma prej: 80,304.47€;
- 1.22 Asfaltimi në Miradi e Epërme, kodi 44788, shuma prej: 5,547.00€;
- 1.23 Asfaltimi në Sllatinë e Vogël, kodi 44786, shuma prej: 76,201.42€;
- 1.24 Asfaltimi në Miradi të Poshtme, kodi 49135, shuma prej: 1,167.40€;
- 1.25 Asfaltimi në Pomozotin, kodi 46251, shuma prej: 30,132.20€;
- 1.26 Asfaltimi në Bardh të Vogël, kodi 44783, shuma prej: 9,339.50€;
- 1.27 Asfaltimi në Harilaç, kodi 89201, shuma prej: 1,488.00€;
- 1.28 Asfaltimi në Sllatinë të Madhe, kodi 44785, shuma prej: 6,222.00€;
- 1.29 Asfaltimi në Vragoli, kodi 40114, shuma prej: 2,786.00€;
- 1.30 Asfaltimi në Nakaradë, kodi 40116, shuma prej: 2,052.00€;
- 1.31 Asfaltimi në Henc, kodi 89202, shuma prej: 3,311.00€ dhe
- 1.32 Asfaltimi në Lismir, kodi 89203, shuma prej: 2,395.00€.
- 1.33 Shërbimet Kulturore Fushë-Kosovë 85002, në projektet: Ndërtimi i fushave të sportit dhe sallës-Fushës së Sportit M, kodi 53995, shuma prej: 114,125.95€;
- 1.34 Ndërtimi sallave të sportit tek objektet shkollore SHFMU L, kodi 53996, shuma prej: 218,432.25€;
- 1.35 Ndërtimi i Palestrës Sportive të Notit, kodi 52521, shuma prej: 150,000.00€;
- 1.36 Palestra Sportive në Sllatinë të Vogël, kodi 51386, shuma prej: 974,542.80€;
- 1.37 Ndërtimi i fushës së sportit në lagjen 028, 029, kodi 53972, shuma prej: 100,000.00€ dhe
- 1.38 Ndërtimi i Sallës së Gjimnastikës në Fushë-Kosovë, kodi 50774, shuma prej: 120,000.00€.
- 1.39 Administrata Fushë-Kosovë Shëndetësi 73011, në projektet: Renovimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, kodi 52816, shuma prej: 40,265.00€.
- 1.40 Administrata Fushë-Kosovë Arsim 92010, në projektet: Ndërtimi i shkollës fillore në Fushë-Kosovë, kodi 44933, shuma prej: 470,725.02€;


- 1.41 Renovimi i objekteve shkollore - Gëzimi Ynë, Bajram Curri, Hasan Prishtina, Hivzi Sulejmani, Vëllezërit Frashëri dhe Selman Riza, kodi 52439, shuma prej: 73,118.72€ dhe
- 1.42 Dixhitalizimi i sistemit edukativo-arsimor, kodi 52493, shuma prej: 41,910.00€.
2. Shpërndarja e mjeteve financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në paragrafin 1, nën - paragrafët 1.1 deri 1.42 janë të detajizuar dhe të përshkruar shpenzimet për secilën kategori të shpenzimeve.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe shfuqizon vendimin Nr. 31, të datës 07.03.2024.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 20.05.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2024, të vazhduar me datën 13.05.2024 dhe 16.05.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 424, të datës 25.03.2024, të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, bënë shqyrtimin e dytë të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 17, shkronja (f), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 15, nenin 34, të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-60, (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, (Gazeta Zyrtare Nr. 29/2022), nenin 8, shkronja (a), nenin 15, shkronja (f), nenin 19, paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, përfshinë mënyrën e menaxhimit të mbeturinave dhe ndarjen e tyre në territorin e komunës.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe rregullores, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shfuqizon vendimin Nr. 142, të datës 07.11.2016 për miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
KRM 'Pastrimi', Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO

Mr.faq/Di.ctr. 73

Date/Datim. 21.05.2024

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 20.05.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2024, të vazhduar me datën 13.05.2024 dhe 16.05.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 427, të datës 22.02.2024, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (ç), nenin 17, shkronja (m), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 18, të Ligjit për Shëndetësinë Nr. 04/L-125, (Gazeta Zyrtare Nr. 13/2023), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (i), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë


1. Për Miratimin e 'Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.
2. Me këtë statut rregullohet organizimi i punës dhe ofrimi i shërbimeve në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe Ambulancave të Mjekësisë Familjare.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shfuqizon vendimin Nr. 40, të datës 29.09.2017 për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për SHMS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 20.05.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2024, të vazhduar me datën 13.05.2024 dhe 16.05.2024, pas shqyrtimit të Kërkesës me Nr. 39, të datës 11.04.2024, e paraqitur nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për ndërrimin e anëtarit të tyre në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinae 'Pastrimi', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 25, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, paragrafi 5.2, nenin 8, paragrafi 8.2, të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, (Gazeta Zyrtare Nr. 31/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

**Për ndërrimin e anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve në
Kompaninë Rajonale të Mbeturinae 'Pastrimi'**


1. Për ndryshimin e paragrafit 1 të vendimit Nr. 171, të datës 05.07.2022, nën paragrafit 1.1, për ndërrimin e anëtarit të deritashëm z. Laureat Gojnovci, me anëtarin e ri z. Jahush Krasniqi dhe caktimin e tij, si anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve, në kuadër të Kompanisë Rajonale të Mbeturinae 'Pastrimi', që operon dhe ushtron veprimtarinë e saj në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
3. Anëtari i Komisionit Komunal të Aksionarëve, e përfaqëson komunën dhe ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe për punën e tij i raporton Kuvendit të Komunës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
KRM 'Pastrimi', Drejtorisë së SHPM, Anëtarit të KKA, dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 20.05.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2024, të vazhduar me datën 13.05.2024 dhe 16.05.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 28/2024, të datës 30.04.2024, të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në lidhje me Kërkesën Nr. 612/2, të datës 24.04.2024, për mbështetjen e projektit për shkollën e futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël të Komunës së Fushë-Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël të Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për caktimin e lokacionit në ngastrën kadastrale Nr. P-72514048-00443-1 me sipërfaqe prej: S = 1.9 ha dhe ngastrën kadastrale Nr. P-7252404800443-2 me sipërfaqe prej: S = 1.5, të evidentuara në certifikatën e pronës së datës 23.04.2024, në vendin e emërtuar 'Suvi Breg', në Zonën Kadastrale Sllatinë e Vogël, në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës, për fillimin e procedurës për realizimin e projektit për 'Ndërtimin e shkollës së futbollit', në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës.
2. Shkolla e futbollit e cekur në pikën një të vendimit, licencohet nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, si shkollë e mesme profesionale për sport, ku regjistrohen 300-500 nxënës nga vendi dhe rajoni.
3. Shkolla e futbollit do të mbështet nga donatorët si federatat kontinentale dhe ndërkombëtare të futbollit: UEFA dhe FIFA, sponzorët dhe donatorët e tjerë të Federatës së Futbollit të Kosovës, për kompletimin e projektit të shkollës dhe hapësirave tjera përcjellëse për zhvillimin e aktivitetit sportiv si: konviktit për fjetje, klasave për mësim dhe ambienteve tjera për rekreacion, me personel mësimdhënës ndërkombëtarë e vendorë dhe njëqind punëtorë të nevojshme për zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve sportive.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për ndarjen gjeodezike të pronës dhe zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit e Pronës dhe Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së KRS, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP dhe
Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

